

1610
20.9.22

Nr. 6358 Prot.

Tiranë, më 20/09 2022

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI** ✓
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Për Dijeni: **Znj. Belinda BALLUKU**
Zv/Kryeministre dhe Ministre
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Ergys VERDHO
Administrator
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Z. Adrian ÇELA
Administrator
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Lënda: **Lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë, për klientët familjarë me konsum mbi 800 Kwh në muaj.**

I Nderuar **Z. Ahmeti**,

Me shkresën Nr. Prot 4201/6 datë 16.09.2022 (bashkëngjitur) Korporata Energjitike Shqiptare ka njoftuar shoqërinë tonë Furnizuesi i Shërbimit Universal për vendimin Nr. 6645/1 datë 08.09.2022 Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit për miratimin e tarifave të shitjes së së energjisë elektrike për FSHU SH.A në të cilën është vendosur që çmimi i për energjinë e klientëve familjarë për konsumin mbi 800 Kwh/muaj të jetë **34.3 Lekë/Kwh**.

Ky ndryshim në rritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për sasinë e konsumuar nga klientët familjarë mbi 800 Kwh/muaj do të rrisë shpenzimet e blerjes së enegjisë për periudhën Tetor – Dhjetor 2022 me rreth 1.8 miliard Lekë sipas parashikimeve në tableën më poshtë:

Niveli Tensionit	Kategoria	Tetor		Nëntor		Dhjetor		3-mujori	Çmimi mesatar i Blerjes (Ishte)	Çmimi mesatar i Blerjes (Bëhet)	Rritja e Shpenzimeve të Blerjes
		Nr Ab.	Kwh	Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh				
0.4 kv	Familjare >800 Kwh)	49,334	19,568,211	71,278	16,566,827	71,278	21,299,059	57,434,097	2.60	34.30	1,820,660,861
Total		49,334	19,568,211	71,278	16,566,827	71,278	21,299,059	57,434,097			1,820,660,861

Kjo shtesë e shpenzimeve do të duhet të rrisë edhe koston vjetore të blerjes së energjisë për vitin 2022, e cila në parashikimet tuaja bazë për marrjen e vendimit Nr. 74 datë 13.04.2022 “Për çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022” në dokumentit “Relacion mbi vlerësimet e ERE për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit universal për periudhën 1.05.2022 31.12.2022” faqja 4, (referuar faqes suaj zyrtare në internet:

https://www.ere.gov.al/images/files/2022/04/29/RELACION_MBI_VLER%C3%8BSIMET_E_ERE_P%C3%8BR_KOSTOT_E_AKTIVITETIT_T%C3%8B_FURNIZUEIST_T%C3%8B_SH%C3%8BRBIMIT_UNIVERSAL_P%C3%8BR_PERIUDH%C3%8BN_1.05.2022_-_31.12.2022.pdf) janë vlerësuar **11,994 milion Lekë.**

Ndërkohë që shpenzimet për njësi të energjisë së shitur për Furnizuesin e Shërbimit Universal sipas këtij dokumenti janë llogaritur sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Shpenzime të FSHU në çmimin e shitjes	Shpenzime në Lekë për Kwh të Shitur
1	Tarifa e Shpërndarjes	6.42
2	Tarifa e Transmetimi	0.85
3	Kosto Administrative	1.06
4	Amortizimi	0.01
5	Disbalanca	0.07
6	Kosto e lejuar e kapitalit të punës	0.03
7	Marzhi	0.06
	Shpenzime FSHU	8.50

Shpenzimet faktike bazuar në të dhënat e 8-mujorit dhe të parashikuara për gjithë vitin 2022 si dhe ato për vitin 2023, janë të ndryshme nga ato të marra në konsideratë në llogaritjet tuaja, për korigjimin e të cilave FSHU SH.A. do të shprehet në dokumentin e aplikimit për çmime të shitjes me pakicë për klientët që furnizohen nga FSHU.

Sipas parashikimeve të FSHU SH.A. llogaritjet e mësipërme do të duhet të plotësohen me koston e shtuar të Borxhit të Keq të ndikuar nga rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga KESH për klientët familjarë me konsum mbi 800 Kwh.

Kosto për njësi e Borxhit të Keq në reacionin e sipër cituar të ERE është llogaritur të jetë 0.53 Lekë për Kwh të shitur. Nga llogaritjet e FSHU si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes së energjisë për periudhën Tetor – Dhjetor nga KESH, kosto për njësi e Borxhit të Keq rezulton të jetë 0.68 Lekë për Kwh të shitur, me një rritje prej 0.15 Lekë/Kwh duke i rritur shpenzimet për njësi të FSHU në 8.65 Lekë/Kwh nga 8.50 Lekë/Kwh llogaritur sipas Relacionit të ERE. Norma e arkëtimit e përdorur në këto llogaritje është bazuar në parashikimet sipas Vendimeve të Qeverisë Shqiptare në Planin e Konsolidimit Financiar prej 95%.

Kostot e Shpenzimeve të FSHU duke llogaritur ndryshimin për shkat të rritjes së Borxhit të Keq paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr.	Shpenzime të FSHU në çmimin e shitjes	Kosto Lekë për Kwh të Shitur
1	Tarifa e Shpërndarjes	6.42
2	Tarifa e Transmetimi	0.85
3	Kosto Administrative	1.21
4	Amortizimi	0.01
5	Disbalanca	0.07
6	Kosto e lejuar e kapitalit të punës	0.03
7	Marzhi	0.06
	Shpenzime FSHU	8.65

Llogaritjet të detajuara për parashikimin e energjisë së shitur sipas grupeve të konsumatorëve dhe nivelit të tensionit për koston e shtuar të Borxhit të Keq paraqiten në tabelën që vijon:

Parashikimi për vitin 2022

PARASHIKIM I SHITJES SE ENERGJISE PER PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2022

Nr.	Niveli Tensionit	Kategoria	Tetor		Nëntor		Dhjetor		3-mujori	Çmimi mesatar i shitjes	Të Ardhura	Borxhi i keq (5%)	Borxhi i keq
			Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh					
1	35 Kv (FMF)	Jo-familjare	18	2,443,543	18	1,870,920	18	1,991,232	6,305,695	33.04	208,340,159	10,417,008	1.65
2	FMF 20/10/6 KV	Jo-familjare	7,804	78,169,284	7,804	89,301,387	7,804	95,044,006	262,514,676	18.72	4,913,093,679	245,654,684	0.94
3	0.4 kv	Jo-familjare	174,744	105,323,126	174,744	113,925,381	174,744	121,251,472	340,499,979	13.67	4,654,443,817	232,722,191	0.68
4	0.4 kv	Familjare Total	867,449	264,313,556	829,857	274,550,975	829,857	292,206,262	831,070,793		9,761,780,673	488,089,034	0.59
4.1	0.4 kv	a) Familjare 1-800 Kwh	818,115	206,164,573	758,579	200,961,748	758,579	213,884,804	621,011,125	9.50	5,899,605,690	294,980,285	0.48
	0.4 kv	b) Familjare mbi 800 Kwh	49,334	58,148,982	71,278	73,589,227	71,278	78,321,459	210,059,668		3,862,174,982	193,108,749	0.92
4.2	0.4 kv	b1) 800+ (Familjare 1-800 Kwh)	49,334	38,580,771	71,278	57,022,400	71,278	57,022,400	152,625,571	9.50	1,449,942,927	72,497,146	0.48
4.3	0.4 kv	b2) 800+ (Familjare 800 + Kwh)	49,334	19,568,211	71,278	16,566,827	71,278	21,299,059	57,434,097	42.00	2,412,232,055	120,611,603	2.10
	Total		1,050,015	450,249,508	1,012,423	479,648,663	1,012,423	510,492,972	1,440,391,143		19,537,658,327	976,882,916	0.68

Sa më sipër jemi në pritje të vendimit tuaj.

Për shkak të kohës së pamjaftueshme për ndryshime në sistemin e faturimit, theksoj nevojën e një vendimi të përshpejtuar.

Me konsideratë,

Elton SEVRANI
Administrator

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A



